



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 385 Prot.

Tiranë më 18 / 06 / 2018

URDHËR

“Për Plotësimin e Trupave Gjykses”

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqsor në Republikën e Shqipërisë, në ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116 dt.29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 238/1/a dt. 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqsore”, si dhe në propozimin e specialistit të IT, deri në përcaktimin e rregullave të reja,

URDHËROJ:

- Plotësimi i trupit gjykses, në rastet e heqjes dorë të ndonjë prej anëtarëve të tij, të kryhet nëpërmjet shortit elektronik, sipas hapave procedural të propozuar nga IKUB dhe specialist i IT.
- Kërkesat, të cilat nuk mund të hidhen në shortin elektronik, të shortohen, manualisht, në ditën e paraqitjes ose në ditën vijuese të punës, në një orar që do të paracaktohet nga Kancelari i Gjykatës.
- Hedhja e shortit manual do të realizohet nga sekretarja gjyqsore Valbona Zenelaj, nën mbikqyrjen e Kancelarit, në sallën 2 të Gjykatës.
- E gjithë praktika të përpilohet në 3 (tre) kopje.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Kancelari, Kryesekretarja Sekretarja Gjyqsore Valbona Zenelaj dhe Specialisti i IT-së.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

